

Terma Reference

Ekspert/Shërbim ofrues i Marrëdhënieve me Publikun (PR) dhe Komunikimit Vizual

Konsulencë	Ekspert i Marrëdhënieve me Publikun (PR) dhe Komunikimit Vizual Gra Rezistente, Komunitete Rezistente për të Fuqizuar të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh
Kohezgjatja e shërbimit	10 muaj
Zona e projektit	Prrenjas, Peqin dhe Belsh
Data e mundshme e fillimit të shërbimit	Gusht 2025 – Maj 2026

Në kuadër të projektit “Gra Reziliente, Komunitete Reziliente për të fuqizuar të mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh”, pjesë e programit RISE HER – Ringritje për Pavarësi dhe Fuqizim të Grave, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga World Vision Albania dhe Forumi i Gruas Elbasan në bashkëpunim me Nisma ARSIS, parashikohet angazhimi i një eksperti për Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimin Vizual.

Ky ekspert do të ketë rol kyç në prodhimin e materialeve të komunikimit dhe vizibilitetit përgjatë gjithë periudhës 12-mujore të zbatimit të projektit, për të siguruar që mesazhet e projektit të përcillen qartë, në mënyrë tërheqëse, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjitet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti “Gra Rezistente, Komunitete Rezistente për të Fuqizuar të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh” synon të ulë dhunën me bazë gjinore dhe të promovojë barazinë gjinore përmes fuqizimit të grave të mbijetuara dhe atyre në rrezik, nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtuara nga komuniteti. Projekti kombinon menaxhimin e rasteve, këshillimin psikosocial e ligjor, ngritjen e kapaciteteve për profesionistët lokalë dhe aktivitete ndërgjegjësuëse në komunitet. I mbështetur në një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, ai vendos në qendër dinjitetin, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e mbijetuarave, duke integruar gjithashtu mjete digjitale për trajnime, akses në informacion dhe lidhje me tregun. Për më tepër, projekti promovon qëndrueshmërinë mjedisore përmes praktikave miqësore me mjedisin në mikro-bizneset e mbështetura.

Objektivat e Angazhimit

Qëllimi i angazhimit është prodhimi i materialeve vizuale dhe të komunikimit për fushatat ndërgjegjësuere dhe aktivitetet e projektit, në përputhje me strategjinë e komunikimit dhe kërkesat e vizibilitetit të donatorit, duke mbështetur drejtpërdrejt ndërgjegjësimin mbi parandalimin e dhunës me bazë gjinore, fuqizimin e mbijetuarave dhe barazinë gjinore.

Roli dhe përgjegjësitë

- Hartojë një plan pune mujor për prodhimin e materialeve PR dhe vizuale në bashkëpunim me ekipin e projektit.
- Zhvillojë dizajne dhe përmbajtje për materiale të printuara (postera, fletëpalosje, broshura, banera, roll-up etj.).
- Prodhon materiale për përdorim digjital (grafika për rrjetet sociale, infografikë, vizuale për media online, titra për video etj.).
- Përgatisë mesazhe publike dhe materiale për fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete komunitare.
- Sigurojë që të gjitha produktet të jenë:
 - a. vizualisht tërheqëse dhe të kuptueshme,
 - b. të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse,
 - c. të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore,
 - d. në përputhje me kërkesat e vizibilitetit të Bashkimit Evropian dhe donatorit.
- Raportoje mbi punën e kryer çdo muaj dhe të dorëzojë produktet për miratim nga ekipi i projektit.

Kualifikimet dhe Eksperienca e Kërkuar

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Arsimi dhe Kualifikimet Akademike:

Eksperti duhet të ketë:

- Diplomë universitare në komunikim, dizajn grafik, marketing ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 5 vite përvojë profesionale në PR, komunikim vizual dhe prodhim materialesh të komunikimit publik.
- Aftësi të shkëlqyera në dizajn grafik dhe njohuri të programeve profesionale (Adobe Illustrator, Photoshop, InDesign, Canva, etj.).
- Përvojë në përgatitjen e materialeve për projekte të mbështetura nga donatorë ndërkombëtarë (veçanërisht BE).
- Aftësi shumë të mira shkrimi dhe përpunimi të mesazheve të qarta, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- Ndjeshmëri ndaj çështjeve të barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është Gusht 2025.

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës Gusht 2025 – Maj 2026.

Kjo ekspertizë përfshin 24 ditë pune.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email:

1. CV-në;
2. Letër interesi që shpjegon dhe përvojën në eksperiencë të ngjashme;

brenda datës **15 Gusht 2025** në info@nisma-arsis.org ose pranë zyrave të Nisma ARSIS, rr. Sali Bukta, Ap. 1, Tirana, Albania.